

## MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, anëtare e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit Flora Reka, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, duke parashtruar arsyetimin tim në pakicë, si vijon:

### **Lidhur me truallin me sip. 500 m<sup>2</sup>, blerë nga Bashkia Himarë**

Me kontratën për shitje trualli, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.8.2002, ndërmjet Bashkisë Himarë, me cilësinë e shitësit dhe subjektit të rivlerësimit Flora Reka dhe vëllait të saj me cilësinë e blerësit është përfituar nga blerësit trualli me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës së paguar prej 200.000 lekësh. Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar se ajo nuk e ka përfituar në kundërshtim me ligjin këtë pasuri dhe se nuk e ka zotëruar këtë pasuri në vijim në mënyrë të padrejtë.

Në përgjigje të barrës së provës së ngarkuar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se dokumenti i përpiluar përmban të gjitha ekstremitetet për të qenë i rregullt si datën, nënshkrimet përkatëse dhe vulën e institucionit Bashkia Himarë dhe se fakti që prona mbetet e paregjistruar në regjistrat përkatës të ZVRPP-së (sot ASHK) nuk mund të bëjë të paligjshëm veprimin juridik të kryer për përfitimin e saj nëpërmjet një akti të rregullt ligjor si kontrata e shitjes me të ardhura të ligjshme, duke deklaruar se do të vijojnë procedurat për regjistrimin e kësaj prone.

Subjekti nuk ka arritur të shpjegojë dhe të provojë ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme, për sa neni 3 i ligjit nr. 7980/1995, “Për shitblerjen e trojeve”, parashikonte se:

*“Derisa të përfundojë kompensimi fizik i ish-pronarëve, kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private lejohet vetëm në rastet që vijojnë:*

*a- Për ndërtimin e banesave me qëllim të lirimit të banesave të ish-pronarëve si dhe për të pastrehët, të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banësive apo persona të tjerë.*

*b- Me vendim të Këshillit të Ministrave, për shitje, për investime shumë të rëndësishme për vendin”.*

Kjo dispozitë ligjore me karakter urdhërues lejon tjetërsimin e trojeve pronë shtetërore në pronë private vetëm në dy raste, për ndërtim banesash për të pastrehë që lirojnë banesat e ish-pronarëve apo me vendim të Këshillit të Ministrave për investime të rëndësishme, sipas vlerësimit rast pas rasti të qeverisë, duke ndaluar tjetërsimin e trojeve shtetërore te persona fizikë a juridikë privatë në raste e për qëllime të tjera.

Bazuar në parashikimet ligjore sa më sipër kontrata për shitje trualli, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.8.2002, ndërmjet Bashkisë Himarë, me cilësinë e shitësit dhe subjektit të rivlerësimit Flora Reka dhe vëllait të saj vjen në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit, pasi trualli nuk është shitur, nisur nga motivet e parashikuara në nenin 3 të ligjit nr. 7980/1995 dhe as në përmbushje të procedurave të privatizimit, legalizimit etj., të treguara në ligje të posaçme.

Parimi i dijenisë së ligjit është njëvlefshmërisht i zbatueshëm për të gjithë. Të gjithë kanë detyrimin ta njohin dhe zbatojnë ligjin. Sikurse Bashkia Himarë edhe subjekti i rivlerësimit Flora Reka, palë në kontratën e shitblerjes së këtij trualli, kishin detyrimin të njohin dhe të zbatojnë ligjin, duke respektuar urdhërimin ndalues ligjor për të mos propozuar apo pranuar

kryerjen e veprimit juridik të shitblerjes së trojeve shtetërore jashtë rasteve të parashikuara në ligj.

Për sa më sipër, vlerësoj se pranimi dhe kryerja e veprimit juridik të shitblerjes së truallit shtetëror, jashtë rasteve të parashikuara në ligj, përbën një situatë që afekton drejtpërdrejt besimin e publikut te drejtësia, për sa subjekti i rivlerësimit kishte detyrim ligjor dhe etik të verifikonte çdo element që ndikon në rastin më të pakët në perceptimin e publikut për zgjedhjet e kryera prej saj në jetën private.

### **Lidhur me apartament 1+1, me sip. 70.7 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*”, Tiranë**

Lidhur me këtë pasuri subjektit iu kalua barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për sa duket se ky apartament është blerë nga subjekti i rivlerësimit përkundrejt vlerës 900.000 lekë dhe figuron në pronësi të saj. Por, subjekti pretendon se pavarësisht parashikimeve të kontratës ka blerë vetëm një pjesë prej 10-12 m<sup>2</sup>, e cila ishte sipërfaqe shtesë më e madhe nga sipërfaqja që i është dhuruar nga babai. Subjekti nuk ka dokumentuar mënyrën se si kjo pasuri i është dhuruar pjesërisht subjektit të rivlerësimit nga babai J. A.. Deri në këto momente mbetet deklarativ dhe i padokumentuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit për dhurimin pjesërisht të kësaj pasurie nga babai i saj dhe blerjen e sipërfaqes shtesë nga kjo pasuri prej 10-12 m<sup>2</sup>, në vlerën 500.000 lekë. Në bazë të dokumentacionit ligjor përfitues i këtij ndërtimi mbetet vetëm vëllai dhe kalimi vetëm te subjekti i rivlerësimit (pa kundërshpërblim) dhe jo edhe te fëmijët e tjerë, mbetet i dyshimtë.

Në përgjigje të barrës së provës së ngarkuar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se: *“Kalimi i pronësisë është i vlefshëm se është pasqyruar edhe në regjistrat e pasurive të paluajtshme në përputhje me kërkesat e nenit 83. Duket sikur është i padokumentuar, pasi nuk ka një kontratë dhurimi të shkruar, por veprimet e kryera kanë qenë në format e parashikuara nga Kodi Civil”.*

Referuar nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *“Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre, ose për veprimet e kryera prej tyre”.*

Sipas përmbajtjes së kontratës këto pohime janë nënshkruar nga palët përpara noterit me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë. Kodi i Procedurës Civile ka përcaktuar aktet zyrtare siç është edhe akti noterial si akt që ka fuqi të plotë provuese. Në bazë të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile kontrata e shitjes përbën provë të plotë të deklarimeve, bërë përpara tyre në tri rastet e parashikuara shprehimisht në ligj:

- deklarime që janë bërë përpara tyre (në rastin konkret noterit);
- për fakte që kanë ngjarë në prani të tyre;
- në veprimet e kryera prej tyre.

Subjekti ka konfirmuar se ka hartuar një dokument noterial me deklarime për fakte ose për veprime që nuk janë kryer, lidhur me mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie apo çmimin e saj dhe, sa më sipër, në drejtim të interpretimit mbi konceptin e cenimit të besimit të publikut afekton drejtpërdrejt besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

### **Lidhur me pasurinë apartament me sip. 51 m<sup>2</sup>, me vendndodhje lagjja \*\*\*, \*\*\*, Durrës**

Për këtë apartament në pronësi të djalit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se shtetasja V. A., nëna e subjektit, ka lëshuar testamentin për këtë pasuri në favor të djalit të subjektit të rivlerësimit vetëm një muaj pas lidhjes së kontratës së shitblerjes së apartamentit në vlerën 3.450.000 lekë, duke përjashtuar nga e drejta e pronësisë të gjithë trashëgimtarët ligjorë.

Lidhur me këtë pasuri, subjektit iu kalua barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 të provojë me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasës V. A., nëna e subjektit, për blerjen e kësaj pasurie, duke u ngritur dyshime të arsyeshme se kjo mund të ketë qenë një pasuri e subjektit të rivlerësimit (djalit së saj), qysh prej fillimit për sa duket se dhuruesja është në pamjaftueshmëri financiare për krijimin e pasurisë apartament.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk u provua mundësia financiare e dhurueses, lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie. Për sa u ngritën dyshime edhe nga subjekti i rivlerësimit nuk u provua mundësia financiare e dhurueses lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, vlerësoj se rrethanat e konstatuara gjatë hetimit administrativ janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se ky apartament është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### **Lidhur me vlerësimin e kriterit të figurës**

Lidhur me komponentin e figurës, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë shpjegime mbi marrëdhënien e saj dhe të bashkëshortit me shtetasin Xh. T., duke i kërkuar shpjegime, për sa në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duhet të kishte deklaruar kontaktin e papërshtatshëm.

Në përgjigje të barrës së provës së ngarkuar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar dhe pretenduar mosnjohjen e saj me pronarin e automjetit të marrë me qira dhe të përdorur prej saj në datën 21.7.2012, kur ka udhëtuar familjarisht për pushime në Parga, në Greqi, së bashku me fëmijët dhe dy nipat e saj.

Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk njihej me pronarin e automjetit të marrë me qira dhe të përdorur prej saj në datën 21.7.2012, kur ka udhëtuar familjarisht për pushime në Parga, në Greqi bie ndesh me qasjen e saj në kontekstin e sigurisë personale edhe të përgjegjshmërisë profesionale. Nga ana e përgjegjësisë profesionale, si prokurore, subjekti minimalisht duhet të ishte e vëmendshme për të evituar, pikërisht, rrethanat që kanë rezultuar se kanë ndodhur – përdorimi prej saj pa shpërblim të automjetit të një individi, i cili rezulton të jetë ndjekur penalisht për veprën penale e cila përfshihet te parashikimet e pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe, për pasojë, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet si person i përfshirë në krimin e organizuar.

Në një qytet të vogël si Durrësi njohjet ndërmjet vendasve janë të konsoliduara dhe perceptimet e personit privat dhe funksionares publike janë përherë të ndërthurura në këndvështrimin e një

qytetari. Përdorimi i automjetit të një personi me probleme me drejtësinë nga një përfaqësuese e zyrës së prokurorisë që ka në juridiksion komunitetin, ku ky individ jeton, është përtej çdo debati një sjellje e cila ndikon në perceptimin negativ të qytetarëve në integritetin, përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e organeve të drejtësisë. Ky element i vetëm faktik ndikon në cenimin e imazhit të organit që përfaqëson akuzën në emër të shtetit ndaj shkelësve të ligjit, çka bën që ndaj subjektit të rivlerësimit të rëndojë parashikimi i pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion, bazuar në provat e administruara, në vlerësimin e çështjes në tërësi, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Flora Reka, për sa kam arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit në vlerësimin tërësor ka cënuar besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**Xhensila PINE**  
**Anëtare/kundër**